



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1079/3 Prot.

Tirane, më 16.04 2024

VENDIM
Nr. 20 dt. 16.04 2024

“PËR
MIRATIMIN E BURSAVE TË STUDENTËVE DHE PËRJASHTIM NGA TARIFA E
SHKOLLIMIT TË CIKLIT TË PARË
TË STUDIMEVE, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS.”

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në zbatim të VKM nr.903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi mbështetës studentor, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar me VKM nr.39 datë 23.01.2019, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të integruar të studimeve që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar me VKM nr. 40 datë 23.01.2019, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.47 datë 29.06.2023 “Mb Miratimin e tarifave të shkollimit për të tre ciklet e studimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës, Vendimin e Bordit të Administrimit nr.70 datë 17.10.2023 “Për miratimin e dokumentacionit për përfitimin e bursës ose të përjashtimit nga tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të parë dhe përjashtimin nga tarifa e shkollimit 50% për studentët e ciklit të dytë për vitin akademik 2023-2024 në UST, në Relacionin e komisionit të shqyrtimit përkatës nr.185/6 datë 02.04.2024 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit përkatës për aplikimet për bursë dhe përjashtim nga tarifa e studimit për ciklin e parë të studimeve, Bordi i Administrimit në mbledhjen e tij të datës 16.04.2024 ,


VENDOSI:

1. Të miratojë listën e studentëve që ndjekin studimet në ciklin e parë të studimeve, program i parë, në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe plotësojnë kriteret për të përfituar bursë, për vitin akademik 2023-2024, të cilët kanë aplikuar deri më 15.12.2023 sipas kriterëve të detajuar, sipas shtojcës 1 bashkëngjitur.
2. Efektet financiare për studentët që kanë aplikuar Brenda afatave të caktuara fillojnë nga fillimi i vitit akademik 2023-2024, dhe studentët që kanë aplikuar pas afatit 15.12.2023 janë llogaritur sipas datës së aplikimit.

3. Ky vendim bashkë me listën e studentëve që përfitojnë bursë dhe përjashtohen nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2023-2024 dhe me efektet financiare të dërgohet dhe në MAS dhe AFKAL.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek Transparenca Universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARTUR COBANI



Kriteri nr.1: Studentët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike

Nr. Nr. matrikullimi	Emër Mbiemër	Nr. prot	Data	Fakul.	Viti	Efekti Financiar i perjashtimit	Efekti Burses
1 EF813A100072	K.S	3397	07.12.2023	FVFR	3	35,000	90,000
2 EF813A120435	Xh.M	735	06.03.2024	FSHR	1	17,500	38,182
TOTALI						52,500	128,182